

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali me mbrojtjen - Blushi: Puç kushtetues me Yeffet, dhjetëra milionë euro para publike për kompa nitë private, pa kontroll shtetëror
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916308/blushi-puc-kushtetues-me-yeffet-dhjetera-milione-euro-para-publike-per-kompanite-private-pa-kontroll-shteteror/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 09:50:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 09:40:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	23664db0a155313d9266bdced39c8ebd6783e9b32378d58fbc3414fcf3552e2d
TEKSTI	a7369857e15bb2ba28f6d5e61a8cfd7f770c0ed82add3e3a0cf92c319c9bffa
PAMJA	d5a3801e429f9e823b04391c27663b5c78284ff61bb472c9883ca4b263e7ecf7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e2ca195dabf519976b3de780e67484aba21d988a02bc6e6268aa532b9a14168f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	da7d1ff5b689218417a9364f9050c9a66c6a0844a6d4715ca23d7f6eb4726c9d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e2ca195dabf519976b3de780e67484aba21d988a02bc6e6268aa532b9a14168f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

më të lexuarat

SYRI TV/ 'Kufizimi i takimeve të Metës, shqetësim serioz', Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK

Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq, përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin



Blushi: Puç kushtetues me Yeffet, dhjetëra milionë euro para publike për kompanitë private, pa kontroll shtetëror

11:40, 13/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, njëherësh deputet i kësaj force politike, Tedi Blushi, ka lëshuar akuza të rënda ndaj kryeministrit Edi Rama lidhur me funksionimin e shoqërisë shtetërore të armatimeve KAYO. Në një deklaratë për mediat, Blushi e cilësoi këtë model si një arkitekturë të mirëfilltë kriminale të ndërtuar për të transferuar dhjetëra miliona euro të taksapaguesve te biznesmenë privatë, duke u shmangur rregullave ligjore të prokurimit publik dhe auditimit shtetëror.

Sipas deputetit të opozitës, ndonëse KAYO është krijuar me 100% kapital shtetëror nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, përmes saj janë ngritur katër kompani bijë me partnerë privatë: Timak Defence, Advanced Arms Technology, MKD dhe Guna Tactical. "Modeli KAYO është një mekanizëm i strukturuar mafioz i ndërtuar nga Edi Rama për zhvatjen e fondeve publike përmes Ron Yeffet dhe 'Ronëve' të tjerë, një puç kushtetues që jo vetëm ka suprimuar kontrollin kushtetues mbi paratë publike, por që nëpërmjet përjashtimit të fondeve publike nga të gjitha rregullat e prokurimit publik, ka krijuar hapësirën për zhvatjen e tyre," deklaroi Blushi.

Deputeti zbrëtheu marifetin ligjor të përdorur, ku shteti mbetet qëllimisht në pakicë aksionesh në secilën prej tyre. "Këto katër kompani, që zotërohen dhe kontrollohen në shumicë nga privati, janë të përjashtuara nga rregullat e prokurimit publik, ashtu si edhe nga auditimi i Kontrollit të Lartë Shtetëror, për shkak se ligji përcakton se i nënshtrohen rregullave vetëm kompanitë ku shteti zotëron më shumë se gjysmën e kuotave. Në kushtet kur të katër shoqëritë kanë ortakë privatë në shumicë, as ligji për prokurimin publik, as ligji për KLSH-në, as auditimi i brendshëm i Ministrisë së Mbrojtjes nuk janë të zbatueshëm ndaj tyre. Shteti paguan, privati menaxhon paratë publike, ndërsa kontrolli kushtetues neutralizohet," u shpreh ai.

Si ilustrim të kësaj skeme, Blushi përmendi rastin e shoqërisë 'Timak Defence', ku 49% e aksioneve iu shitën për vetëm 490 euro biznesmenit izraelit Ron Yeffet, ndërsa KAYO mban vetëm 20%. Kjo kompani, sipas të dhënave të bëra publike, ka përfutur deri në 30 milionë euro nga Buxheti i Shtetit pa iu nënshtruar asnjë garë apo prokurimi publik. Ngjashëm, te 'Guna Tactical', shteti humbi shumicën

duke zbritur në 49% të aksioneve, ndërsa kompania ka marrë rreth 8 milione euro nga fondet publike.

Në përmbyllje të deklaratës, Sekretari i Përgjithshëm i PL-së njoftoi hapat e mëtejshëm politikë dhe ligjorë për ballafaqimin me këtë skandal, duke përmendur edhe rreziqet për sigurinë kombëtare nga trafikimi i armëve. "Tanimë opozita e ka depozituar nismën e saj për ngritjen pa vonesë të komisionit hetimor parlamentar që do të përqendrojë punën e tij në verifikimin në thellësi të ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga Edi Rama gjatë funksionimit të shoqërisë shtetërore KAYO sh.a., në drejtim të marrëveshjeve të bashkëpunimit, marrëdhënieve kontraktuale, prodhimit, importit, eksportit dhe tregtimit të armëve, duke mbajtur në konsideratë edhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar në NATO," përfundoi Blushi.

Deklarata e plotë:

Modeli KAYO është një mekanizëm i strukturuar mafioz i ndërtuar nga Edi Rama për zhvatjen e fondeve publike përmes Ron Yeffet dhe "Ronëve" të tjerë, një puç kushtetues, që jo vetëm ka suprimuar kontrollin kushtetues mbi parandë publike, por dhe që nëpërmjet përjashtimit të fondeve publike nga të gjitha rregullat e prokurimit publik, ka krijuar të hapësirën për zhvatjen e tyre.

KAYO është shoqëri me 100% kapital shtetëror, nën Ministrinë e Mbrojtjes, por përmes saj janë krijuar katër kompani të përbashkëta me privatët: Timak Defence, Advanced Arms Technology, MKD dhe Guna Tactical.

Në tre prej tyre KAYO zotëron vetëm 20% të aksioneve, ndërsa në njërin 49%, duke e lënë shtetin në pakicë në të katër kompanitë, megjithëse aktiviteti i tyre lidhet drejtpërdrejt me furnizimin e shtetit me mjete ushtarake, dronë, armë, municione, veshje dhe pajisje strategjike.

Këtu qëndron thelbi i skemës mafioze dhe puçit kushtetues.

Këto katër kompani, që zotërohen dhe kontrollohen në shumicë nga privati, janë të përjashtuara nga rregullat e prokurimit publik, ashtu si edhe nga auditimi i Kontrollit të Lartë Shtetëror, për shkak se ligji për prokurimin publik, ashtu si edhe ligjin për KLSH, përcaktojnë se i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik dhe auditimit financiar vetëm kompanitë në të cilat shteti zotëron më shumë se gjysmën e kuotave/aksioneve.

Në kushtet kur të katër shoqëritë kanë ortakë privatë në shumicë, atëherë si ligji për prokurimin publik, ashtu edhe ligji për KLSH-në, ashtu edhe auditimi i brendshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, nuk janë të zbatueshëm ndaj tyre.

Ky mekanizëm mafioz përjashton qëllimisht jo vetëm auditorët dhe publikun nga kontrolli, llogaridhënia dhe transparenca por edhe vet Kuvendin.

Rasti i TIMAK-ut e bën këtë mekanizëm edhe më të qartë: më 17 qershor 2025, 49% e aksioneve janë shitur për vetëm 490 euro shtetasit izraelit Ron Yeffet dhe vetëm pak javë më pas është krijuar Timak Defence, ku KAYO zotëron vetëm 20%. Ndërkohë, sipas të dhënave të bëra publike në media, kjo kompani ka përfituar rreth 26 milionë euro nga Buxheti i Shtetit deri në qershor 2026.

Në Guna Tactical, KAYO fillimisht zotëronte 51%, por në maj 2026 zbrit në 49%, duke humbur shumicën dhe kontrollin, ndërsa kompania ka përfituar rreth 8 milionë euro nga Buxheti i Shtetit deri në maj 2026.

Pra, modeli mafioz është i qartë.

Shteti paguan, privati menaxhon parandë publike, ndërsa kontrolli kushtetues mbi të neutralizohet.

Prandaj, modeli mafioz KAYO nuk është një partneritet normal publiko-privat.

Është një arkitekturë kriminale për zhvatjen e parasë publike e ndërtuar për të çuar fondet publike në struktura me shumicë private, për të shmangur mekanizmat e zakonshëm të prokurimit dhe kontrollit shtetëror dhe për të neutralizuar de facto kontrollin e KLSH-së, ndërkohë që shteti vazhdon të jetë klienti dhe financuesi kryesor.

Pra shteti përmes KAYO-s në këto kompani ka pakicën e aksioneve. Që do të thotë se Ligji i Prokurimit Publik, që zbatohet vetëm në entet shtetërore dhe në kompanitë në të cilat shteti ka shumicën e administrimit, nuk ka efekt të Ron Yeffet dhe "Ronët e tjerë".

Ligji i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk zbatohet sepse kompanitë private, ku shteti është aksioner në pakicë, nuk prokurojnë me tendera, dhe se këto katër kompani nuk kontrollohen as nga auditimi i brendshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, sepse edhe ai kontrollon kompanitë ku shumica është e shtetit.

Vetëm me këtë mekanizëm mafioz, nga KAYO, që presupozohet të kryente vetë shërbimet e furnizimit të shtetit me mjete ushtarake, dronë, armë, municione

SYRI TV/ Rama reagon pas kallëzimit ndaj Ministrisë së Financave, kërcënon gjyqtarët dhe prokurorët

Pengimi i drejtësisë/ Prokuroria në Hagë kërkon 6 vjet burgim për Hashim Thaçin

'Po blejnë influencë të zyrtarëve të BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

shtetimit për funksionim e shtetit me njëje ushtarake, drone, arme, municione, veshje dhe pajisje strategjike, kalohet te katër kompani private ku shteti ka pakicën, pikërisht për t'i përjashtuar totalisht nga të gjitha rregullat e prokurimit publik, rregullat e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe rregullat e auditimit financiar që bën çdo institucion, në mënyrë që Edi Rama nëpërmjet Ron Yeffet dhe "Ronëve" të tjerë të vjedhë i qetë, pa u kontrolluar nga askush.

Një nga kushtet bazë të organizimit dhe funksionimit të një shtetit demokratik është se nëse po përdoren paratë publike çdo transaksion duhet t'i nënshtrohet rregullave të prokurimit.

Sot ky kusht themeltar është shkelur.

Për shembull, "Timak Defence" një kompani e cila është 80 % private edhe 20 % shtetërore, ka përfituar deri tani 30 milion euro të cilat i janë shmangur prokurimit, edhe jo vetëm Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe audit i brendshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, por as Kuvendi nuk ka asnjë mekanizëm kontrolli mbi përdorimin e tyre në garantim të interesit publik.

Që do të thotë, se këto katër kompani veprojnë njësoj si çdo kompani private. Por, me një ndryshim, klienti i tyre kryesor dhe monopol është shteti.

Në këtë model mafioz, shteti paguan, privati kontrollon, prokurimi anashkalohet, auditimi publik dobësohet dhe qytetari shqiptar mbetet pa garancinë e transparencës dhe llogaridhënies mbi paratë e tij.

Modeli mafioz KAYO provon qartë korporatizimin e shtetit me anë të krijimit të kompanive shtetërore, të cilat krijojnë të tjera kompani bija me aktor privat të lidhur drejtpërdrejt me Edi Ramën, të zgjedhura pa garë, të cilët marrin akses në burimet ose asetet publike, ndërsa anashkalojnë rregullat e prokurimit, kontrollit edhe llogaridhënies.

Ndryshe kjo quhet kapje e shtetit përmes një puçi kushtetues që suprimon kontrollin mbi paranë publike.

Sepse ky mekanizëm mafioz përjashton qëllimisht jo vetëm auditorët dhe publikun nga kontrolli, llogaridhënia dhe transparenca, por edhe vet Kuvendin.

Pra një vjedhje në dritë të diellit, që nuk ka nevojë për ndonjë hetim të thelluar dhe që në kushtet kur drejtësisht nuk do të ishte e kapur nga Edi Rama do të duhej të reagoje menjëherë, veçanërisht kur audio-përgjimi i Ron Yeffet i vuri vulën mënyrës mafioze të zhvatjes së parasë publike nga Edi Rama.

Por në kushtet kur SPAK as nuk ka guximin t'i afrohet celularit të Edi Ramës dhe as ta thërrasë atë të pandehur çdo iluzion se drejtësia do të reagojë edhe në këtë rast është një iluzion.

Megjithatë kjo gjakderdhje financiare përmes modelit mafioz KAYO, që pritet të zgjerohet edhe në sistemin e shëndetësisë duhet ndalur urgjentisht.

Ne do t'i zhbëjmë këto skema mafioze të grabitjes së parasë publike.

Tanimë opozita e ka depozituar nismën e saj për ngritjen pa vonesë të komisionit hetimor parlamentar që do të duhet të përqendrojë punën e tij në verifikimin në thellësi të ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga Edi Rama gjatë funksionimit të shoqërisë shtetërore "KAYO" sh.a., në drejtim të marrëveshjeve të bashkëpunimit, marrëdhëniet kontraktuale, prodhimit, importit, eksportit dhe tregtimit të armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake, duke mbajtur në konsideratë edhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar me të drejtë të plota në NATO, veçanërisht në kushtet kur siç faktoi edhe audio-përgjimi i Ron Yeffet jemi në kushtet e cënimit flagrant të sigurisë kombëtare përmes përfshirjes së Shqipërisë në trafikun ndërkombëtar të armëve.

Partia e Lirisë është e vendosur t'i çmontojë një për një modelet mafioze KAYO, të rikthejë kontrollin e shtetit mbi pasurinë publike dhe t'u kërkojë llogari të gjithë atyre që e kanë trajtuar paranë e shqiptarëve si plaçkë personale.

KAYO-organizata do të çmontohet dhe Edi Rama do të japë shumë shpejt llogari para shqiptarëve për zhvatjen barbare që u ka bërë taksave të tyre.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Pagat në drejtësi/ Rama sulmon gjyqtarët pas padisë ndaj Ministrisë të Financave: Duan, 'vetë Zot e vetë Shkop'



Rama hap 4 universitete, Shkodra mbetet jashtë/ Boçi: Hakmarrje politike



Konstituohet Kuvendi i Kosovës pa nënkryetar të PDK/ Tanja Vujoviq zgjidhet nënkryetare nga radhët e komunitetit serb

TË NGJASHME



PDK tërhiqet nga seancat e Kuvendit: Procesin do ta çojmë në Gjykatën Kushtetuese



Drejtesia nuk mund të funksionojë me dy shpejtësi, as me dy standarde



Vazhdimi i seancës konstituive sot nga ora 10:00, ky është rendi i ditës



105 ditë protestë/ Diaspora kërkon fillimin e mosbindjes civile: Bllokoni rrugët e Tiranës



'Duhet të rrëzohet qeveria e Ramës!' Protestuesit dhe diaspora nuk largohen nga sheshi



'Divjaka e qytetarëve, jo e tradhëtarëve' / Sot dita e 44-t e protestës kundër bashkimit me Lushnjën



LVV: Votojmë Vlorë Çitakun e Kujtim Shalën për nënkryetarë të Kuvendit

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendeni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.